



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Nr. ref: 275-276/2026
Datë: 23.07.2026

Bazuar në nenin 14 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr. 05/2019 për Arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike:

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Shpall

KONKURS

Për zgjedhje/ri-zgjedhje/avancim të personelit akademik me marrëdhënie të rregullt të punës në Fakultetin e Sigurisë Publike

1. NJË MËSIMDHËNËS PËR LËNDËT: Psikologjia në sigurinë publike; Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve; Parandalimi i stresit në punë dhe djegies profesionale; Sjellja organizative.

2. NJË MËSIMDHËNËS PËR LËNDËT: Parandalimi i krimit; Kriminalistika dhe taktika e hetimit të krimit; Krimi i organizuar; Krimi dhe siguria mjedisore.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret për zgjedhje/ri-zgjedhje/avancim në titullin akademik përkatës, në përputhje me Rregulloren Nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren (AKA) Nr. 04/2024, punimet shkencore të kërkuara për titullin akademik përkatës duhet të jenë të publikuara në revista të indeksuara në SCOPUS ose Web of Science (SCIE, SSCI ose AHCI), ku kandidati është autor i parë ose autor korrespondent, duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta. Në datën e aplikimit, revista nuk duhet të jetë e përjashtuar nga SCOPUS ose Web of Science.

Procedura e zgjedhjes/ri-zgjedhjes/avancimit e personelit akademik do të zhvillohet në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Personeli akademik do të angazhohet në mësimdhënie në programet studimore të arsimit të lartë, në veprimtari kërkimore-shkencore, në mësimdhënie në trajnime, në zhvillimin dhe përditësimin e kurrikulave, si dhe në detyra të tjera sipas nevojave institucionale.

Kandidatët që aplikojnë në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim ku specifikohet pozita dhe grupi i lëndëve;
- CV-në profesionale;
- Ekstraktin e lindjes (jo me i vjetër se 6 muaj) dhe kopjen e dokumentit identifikues;
- Certifikatën e evidencës penale (jo me e vjetër se 6 muaj);
- Kopjet e diplomave të tri cikleve të studimit: të studimeve themelore bachelor, master/magjistraturë dhe të doktoratës (të gjitha diplomat duhet të jenë të noterizuara);
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës nga MASHT (vlen për kandidatët që kanë përfunduar ndonjë nga ciklet e studimeve jashtë vendit);
- Dëshmitë për publikimet shkencore të publikuara në revista të indeksuara në SCOPUS ose Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI);
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie në arsimin e lartë, përfshirë kopjet e vendimeve paraprake për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe/ose avancimin në tituj akademikë;
- Informata apo të dhëna tjera shtesë të cilat konsiderohen të rëndësishme.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike:

- Në kopje fizike dokumentet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr. 01;
- Në kopje elektronike, dokumentet dorëzohen të skanuara në adresën elektronike: rekrutimi.aksp@rks-gov.net ;

Si të sakta dhe të vërteta konsiderohen vetëm të dhënat e dëshmuara me dokumentacion përkatës (jo edhe ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj, është përparësi.

Aplikacionet e pranuar pas afatit, si dhe ato të pakompletuara sipas kërkesave të konkursit, nuk do të shqyrtohen dhe do të refuzohen.

Konkursi mbetet i hapur për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri më datën 07.08.2026, në ora 16:00.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar në faqen e internetit: www.aksp-ks.net

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit, në numrin e tel: 028 590 070 ext. 213 ose 118, prej orës 08:00 - 16:00.